Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a.**Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b.**Prokura e posaçme.

**Shënim: Në Informacionin që do të plotësohet në Shtojcën 5, dhe i përket personi/at për të cilin/at do të pasqyrohen të dhënat në Deklaratën për përmbushjen e Krit. Të Përgj., për efekt verifikimi nga AK, duhet të jetë i plotë ku të përfshijë: atësinë /mëmësinë /datëlindjen /vendlindjen e personit/ave.*

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

dh. Vërtetimin* që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

**Shënim: Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezultojnë se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

- Subjekti duhet të ketë Leje Mjedisi sipas Ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”:

Operatori duhet të jetë i pajisur me **Leje Mjedisi të Tipit A (Kat. 5.1.a)** ose **‘Leje Mjedisi e Tipit B (stacion transferimi mbetjesh të rrezikshme)’**, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, e lëshuar nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit.

- Operatori duhet të jetë i pajisur me çertifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- Operatori, duhet të jetë i pajisur me çertifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” ose EMAS (Eko – Menaxhim dhe Skema Auditit)** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- Operatori, duhet të jetë i pajisur me çertifikatën **OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” ose ISO 45001:2018**, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike secili prej operatoreve duhet të përmbushë kriteret ligjore të kërkuara me sipër.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të çertifikuara të balanceve të tre viteve të fundit (**2017, 2018, 2019**) të operatorit ekonomik pjesëmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatesë dhe të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2017, 2018,2019**) ku vlera mesatare e tyre të jetë **sa vlera e fondit limit** të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Për kapacitetin teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohet kontrata/kontratat përkatëse të shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/të tyre.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar në përbërjen e të cilit duhet të jetë minimalisht:

- një inxhinier i përshtatshëm me objektin e kontratës (ing. Mjedisi ose ing. Kimist), vërtetuar me CV, kontrate punë dhe liçensat profesionale ose dëshmi të formimit profesional në përputhje me objektin e kontratës.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të përcaktohet Këshilltari i Sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, së bashku me çertifikatë të vlefshme të formimit profesional të tij, këshilltari i sigurisë duhet të jetë në marrëdhënie pune të vërtetuar me operatorin ekonomik (vërtetuar me kontratë ndërmjet palëve).

ç) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një autodeklarate ku të deklarohej se të gjitha materialet që do të përdoren për ambalazhim janë të miratuara nga Institucionet përkatëse sipas dispozitave të ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” dhe VKM Nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"ose sipas kushteve të përcaktuara të ambalazhimit “ADR” (Miratuar me ligjin nr. 9272, datë 16.09.2004 “Për aderimin e RSH në Marrëveshjen Europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”.

d) Operatori duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të specifikojë nëse mbetjet objekt prokurimi do të trajtohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë kufijve të saj. Në rastet e trajtimit brenda territorit, në autodeklaratë duhet të pasqyrohet vendi ku do të bëhet asgjësimi i

mbetjeve objekt i kësaj kontrate, për rastet e eksportit ndërkombëtar të mbetjeve, operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Autorizim për eksport të mbetjeve, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për mjedisin (MTM) sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve”, vlefshmëria e të cilit duhet të mbulojë vlefshmërinë e kontratës. Në rastin kur OE nuk është i pajisur me Autorizim, duhet të deklarojë afatin maksimal brenda të cilit mund të pajisjet me autorizim në rast se shpallet fitues.

dh) Kur mbetjet do të trajtohen/asgjesohen brenda Territorit të RSH, OE ofertues, duhet të ketë në pronësi ose me qera implant për trajtimin e mbetjeve spitalore për të përballuar sasinë e mbetjeve të parashikuar në shtojcën 10 të DST, 6600 kg për periudhën e parashikuar në DST, sipas Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore (*për mbetjet citotoksike*). Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë lejen mjedisore të implantit të lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (të vlefshme), ku të parashikohet trajtimi i mbetjeve objekt prokurimi si dhe certifikatën e pronësisë ose kontratën e qirasë për të provuar disponimin e implantit. Në rastin e eksportit jashtë territorit të RSH., OE duhet të deklarojë stacionin e transferimit që ndodhet brenda RSH.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Lloji i makinerise (pajisjes)	Njesia	Sasia
Automjet të posaçëm* , të pajisur me sinjalistikën përkatëse për transport mbetjesh të rrezikshme spitalore	Copë	1
Peshore e çertifikuar	copë	1

- Për automjete që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (çertifikatën e pronësisë, leje qarkullimi (lëshuar nga DPSHTRR), Akt kolaudimi SGS (i vlefshëm), Siguracion të vlefshëm, taksat vjetore (DPSHTRR), Në rast eksporti të mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe çertifikatë trajnimit profesional ADR për shoferin që do të drejtojë mjetin e kërkuar, për transport mallrash të rrezikshme, të vlefshme, si dhe çertifikaten e pronësisë së mjetit së bashku me kontratën e qirasë kur mjeti është i marrë me qira.
- Pershorma duhet të jetë e çertifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

***Sgarim:** Mjeti i kërkuar si më sipër, duhet të jetë sipas përshkrimit: “**plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar**”, sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt të Mbetjeve Spitalore”, Seksioni: 9.3.3 ‘**Atomjetet/anijet e grumbullimit**’; Gjithashtu automjeti duhet të plotësojë edhe kriteret e pikës 8.8/c dhe shtojcën 4 të VKM nr.798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Emërtimi	Njësia
1	“Trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza” (për 12 muaj).	Kg

Specifikimet teknike:

1. Subjekti që do të shpallet fitues është i detyruar të kryejë shërbimin e evadimit nga QSUNT dhe asgjësimin e mbetjeve citostatike dhe citotoksike.
2. Në rast se mbetjet citostatike-citotoksike do të trajtohen brenda Republikës së Shqipërisë apo transportohen jashtë vendit, operatori ekonomik, duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.
3. Transporti i mbetjeve do të kryhet me mjete të posaçme për transportin e mallrave të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi. Ligjit Nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.
4. Të bëhet pajisja me tabela informuese për shmangien e rreziqeve dhe pasojave me ndikim në mjedis në automjetet e transportit dhe kontenitorët që do futen këto mbetje, sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme.
5. Mbetjet e vendosura në qese do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve, ku do hartohet procesverbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë amballazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Pas peshimit, mbetjet ambalazhohen në kutitë përkatëse për t’u transportuar nga operatori. Ky proces, shkruhet dhe në regjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.
6. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, në periudha kohore mujore përkatëse si dhe proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të QSUT).
7. Terheqja dhe peshimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do behet sipas grafikut të percaktuar nga AK, në vendin e percaktuar nga ky i fundit si dhe pagesa do të bëhet në bazë të kilogramëve të tërhequra sipas proces-verbaleve të firmosur nga të dyja palët.
8. I gjithë procesi i selektimit dhe tërheqjes së mbetjeve citostatike-citotoksike do të kryhet me maska dhe veshje të posaçme për këtë procedurë.
9. Mbetjet citostatike-citotoksike duhet të vendosen në enë jo-reaktive.
10. Kudo që të jetë e mundur, këto mbetje duhet të incenerohen. Ato nuk duhet të dërgohen në landfill apo të shkarkohen në sistemin e kanalizimit.

11. Subjekti duhet të ofrojë garancinë që ambalazhimi dhe trajtimi i mbetjeve citostatike do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
12. Duhet të jetë prezente një peshore e certifikuar nga Drejtoria e Përgjithsme e Metrologjisë së Republikës së Shqipërisë, për të peshuar këto mbetje. Peshimi do të kryet në prezencë të personave përgjegjës të QSUNT dhe subjektit. Do mbahen proçes verbal.
13. Subjekti do të furnizojë me materiale ndihmëse për gjatë gjithë ecuresë deri në evadim të plotë të mbetjeve nga QSUNT.
14. Marrësi në dorëzim, brenda 30 ditëve, i dërgon dorëzuesit (QSUNT) një konfirmim me shkrim për marrjen e mbetjeve të rrezikshme dhe informacion mbi ecurinë e proçedurës.
15. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit.
16. Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht një makinë të vërtetuar me certifikatë pronësie dhe të ketë sinjalistikën përkatëse për transport të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe të jetë i pajisur me leje për transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore

Në rast së subjekti i trajton mbetjet jasht territorit të Republikës së Shqipërisë :

1. Në rastë së subjekti nuk i trajton mbetjet brënda territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë duhet të mbajë proçes verbal për etapën e parë të punës që është ndarje, klasifikim, mbledhja, paketimi i mbetjeve, si edhe etapa e dytë e ngarkimit, transportit, eksportin e mbetjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Në rast eksporti të këtyre mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe liçensa ADR për transport të mbetjeve të rrezikshme. Në rast mundësie të transportit ndërkombëtar, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke u referuar në Konventën e Bazelit, subjekti duhet të ketë Autorizimet përkatëse.
3. Ndarja-Klasifikimi-Paketimi-Etiketimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do bëhet në fuqi dhe/ose thasë, dhe /ose kontenier, 1A2 approved, të etiketuara me shenjën e mbetjeve citstatike – citotoksike, sipas proçedurave të miratuara nga BE. Gjithashtu duhet të etiketohen dhe markohen sipas direktivave të ADR “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”, nga personeli i firmës që do të bëjë asgjësimin.
4. Mbetjet e vendosura në qese do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve, ku do hartohet procesverbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUNT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Pas peshimit, mbetjet ambalazhohen në kutitë përkatëse për t’u transportuar nga operatori. Ky proces, shkruhet dhe në regjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.
5. Ngarkimi në kamion do të supervizohet nga një inxhinier i fushës, staf i firmës si dhe personat përgjegjës të QSUNT. Njëkohësisht, edhe subjekti dhe Q SUNT do të jenë përgjegjës për koordinimin dhe ekzekutimin e kësaj proçedure.
6. Transporti do të realizohet pas miratimit të lejes së lëvizjes ndërkufitare nga autoritetet përkatëse në Shqipëri dhe në vendin ku do të eksportohen këto mbetje.
7. Autorizimet e eksportit, për trajtimin e këtyre mbetjeve duhet të jenë të miratuara nga Ministritë e Mjedisit të të dyja palëve të vëndeve dhe do të jenë në përputhshmëri me konventën e Baselit 1989, si dhe rregullores Europiane 1013/2006.
8. Të gjitha dokumentacionet doganore do të jenë përgjegjësi e subjektit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	“Trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza” (për 12 muaj).	Kg	6600

Afatet e ekzekutimit: **Nga data e lidhjes së Marrëveshjes Kuadër për një afat 12 muaj, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.**

Shënim: Lidhja e kontratave brenda Marrëveshjes Kuader do të bëhet sipas kërkesës së Shërbimeve përkatëseve të Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 11

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”** (për 12 muaj).

Detyrat:

1. Subjekti që do të shpallet fitues është i detyruar të kryejë shërbimin e evadimit nga QSUNT dhe asgjësimin e mbetjeve citostatike dhe citotoksike.
2. Në rast se mbetjet citostatike-citotoksike do të trajtohen brenda Republikës së Shqipërisë apo transportohen jashtë vendit, operatori ekonomik, duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.
3. Transporti i mbetjeve do të kryhet me mjete të posaçme për transportin e mallrave të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi. Ligjit Nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.
4. Të bëhet pajisja me tabela informuese për shmangien e rreziqeve dhe pasojave me ndikim në mjedis në automjetet e transportit dhe kontenitorët që do futen këto mbetje, sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme.
5. Mbetjet e vendosura në qese do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve, ku do hartohet procesverbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të këtij proces verballi mbeten në QSUT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Pas peshimit, mbetjet ambalazhohen në kutitë përkatëse për t’u transportuar nga operatori. Ky proces, shkruhet dhe në regjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.
6. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, në periudha kohore mujore përkatëse si dhe proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të QSUT).
7. Terheqja dhe peshimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do behet sipas grafikut të percaktuar nga AK, në vendin e percaktuar nga ky i fundit si dhe pagesa do të bëhet në bazë të kilogramëve të tërhequra sipas proces-verbaleve të firmosur nga të dyja palët.
8. I gjithë procesi i selektimit dhe tërheqjes së mbetjeve citostatike-citotoksike do të kryhet me maska dhe veshje të posaçme për këtë procedurë.
9. Mbetjet citostatike-citotoksike duhet të vendosen në enë jo-reaktive.
10. Kudo që të jetë e mundur, këto mbetje duhet të incenerohen. Ato nuk duhet të dërgohen në landfill apo të shkarkohen në sistemin e kanalizimit.
11. Subjekti duhet të ofrojë garancinë që ambalazhimi dhe trajtimi i mbetjeve citostatike do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
12. Duhet të jetë prezente një peshore e certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë së Republikës së Shqipërisë, për të peshuar këto mbetje. Peshimi do të kryet në prezencë të personave përgjegjës të QSUNT dhe subjektit. Do mbahen proces verbal.
13. Subjekti do të furnizojë me materiale ndihmëse për gjatë gjithë ecurisë deri në evadim të plotë të mbetjeve nga QSUNT.
14. Marrësi në dorëzim, brenda 30 ditëve, i dërgon dorëzuesit (QSUNT) një konfirmim me shkrim për marrjen e mbetjeve të rrezikshme dhe informacion mbi ecurinë e procedurës.

15. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit.
16. Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht një makinë të vërtetuar me certifikatë pronësie dhe të ketë sinjalistikën përkatëse për transport të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe të jetë i pajisur me leje për transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore

Në rast së subjekti i trajton mbetjet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë :

1. Në rastë së subjekti nuk i trajton mbetjet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë duhet të mbajë proces verbal për etapën e parë të punës që është ndarje, klasifikim, mbledhja, paketimi i mbetjeve, si edhe etapa e dytë e ngarkimit, transportit, eksportin e mbetjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Në rast eksporti të këtyre mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe licenca ADR për transport të mbetjeve të rrezikshme. Në rast mundësie të transportit ndërkombëtar, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke u referuar në Konventën e Bazelit, subjekti duhet të ketë Autorizimet përkatëse.
3. Ndarja-Klasifikimi-Paketimi-Etiketimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do bëhet në fuqi dhe/ose thasë, dhe /ose kontenier, 1A2 approved, të etiketuara me shenjë e mbetjeve citstatike – citotoksike, sipas procedurave të miratuara nga BE. Gjithashtu duhet të etiketohen dhe markohen sipas direktivave të ADR “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”, nga personeli i firmës që do të bëjë asgjësimin.
4. Mbetjet e vendosura në qese do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve, ku do hartohet procesverbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Pas peshimit, mbetjet ambalazhohen në kutitë përkatëse për t’u transportuar nga operatori. Ky proces, shkruhet dhe në regjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.
5. Ngarkimi në kamion do të supervizohet nga një inxhinier i fushës, staf i firmës si dhe personat përgjegjës të QSUNT. Njëkohësisht, edhe subjekti dhe Q SUNT do të jenë përgjegjës për koordinimin dhe ekzekutimin e kësaj procedure.
6. Transporti do të realizohet pas miratimit të lejes së lëvizjes ndërkufitare nga autoritetet përkatëse në Shqipëri dhe në vendin ku do të eksportohen këto mbetje. Autorizimet e eksportit, për trajtimin e këtyre mbetjeve duhet të jenë të miratuara nga Ministritë e Mjedisit të të dyja palëve të vëndeve dhe do të jenë në përputhshmëri me konventën e Baselit 1989, si dhe rregullores Europiane 1013/2006.
7. Të gjitha dokumentacionet doganore do të jenë përgjegjësi e subjektit.

Shpërndarja: **“Trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”** (për 12 muaj).

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tirane**

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

**KUSHTET E PËRGJITHSHME
Shërbimet–Kërkesë për propozim**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjatë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
